



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 374, Datë 26.12.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “M.C. ENERGJI GOJAN” SH.P.K., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GOJAN”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 11, pika 2, 13, pika 2, gërma “a” dhe 14, pika 2 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2277/6 prot., datë 20.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Gojan”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2277 prot., datë 12.10.2023, depozitoi aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 305, datë 23.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.10.2023 dhe 26.10.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2334 prot., datë 24.10.2023, ERE ka njoftuar MIE-n për fillimin e kësaj procedure, ndërsa me shkresën nr. 2277/3 prot., datë 31.10.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht nga shoqëria.
- Me shkresën me nr. 2277/4 prot., datë 20.11.2023, shoqëria ka kthyer përgjigje duke përcjellë në ERE një pjesë të dokumentacionit të konsideruar të munguar, por pa e plotësuar tërësisht atë.

- ERE me shkresën me nr. 2277/5 prot., datë 23.11.2023 ka njoftuar sërish shoqërinë për dokumentacionin e rezultuar të paplotësuar duke kërkuar të depozitohet brenda 5 ditëve nga marrja e shkresës.
- Për sa më sipër dërguar nga ERE, rezulton se shoqëria “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. nuk ka kthyer një përgjigje për sa dërguar dhe nuk rezulton që të ketë depozituar asnjë shkresë apo dokumentacion për të përmbushur sa kërkuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga neni 9, pika 1.3 gërmat “a” dhe “b”; pika 2.1 gërmat “a” dhe “c” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, dhe ka depozituar në formatin fotokopje dokumentacionin e kërkuar nga neni 9, pika 1.3 gërmat “b”, “c” dhe “d”, ndaj vlerësohet që ky aplikim të refuzohet.
- Në nenin 11, pika 2 dhe në nenin 13, pika 2, gërma “a” të Rregullores përcaktohet se: *Nëse aplikuesi nuk paraqet informacionin shtesë brenda afatit, formës dhe përmbajtjes së caktuar, kjo do të përbëjë kusht për refuzimin e aplikimit e po ashtu se Në marrjen e vendimit për licencimin ose refuzimin e licencimit të një shoqërie aplikuese, Bordi i ERE-s merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:*
  - a. *plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion shtesë të ERE-s.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Gojan”, në pellgun ujëmbledhës të lumit “Fani i Madh” në zonën e Gojan-Gjegjanit, Qarku Shkodër.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**